

Në bazë të nenit 155, paragrafit 10, të Ligjit për arsimin e lartë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 82/2018) dhe në bazë të nenit 27, paragrafit 1, pikës 6 dhe nenit 111, të Statutit të Universitetit të Evropës Juglindore, Bordi i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 9.09.2019 miratoi këtë:

RREGULLORE PËR PËRMBAJTJEN DHE FORMËN E DIPLOMËS, SHTOJCËS SË DIPLOMËS, CERTIFIKATËS SË DIPLOMIMIT DHE DOKUMENTE TJERA TË LËSHUARA NGA UNIVERSITETI

I. Objekti i rregullimit

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen përmbajtja dhe forma e diplomës, shtojcës së diplomës, certifikatës së diplomimit dhe dokumente të tjera (transkripti i notave dhe karta e studentit), të lëshuara nga Universiteti.

II. Forma dhe përmbajtja e diplomës

Neni 2

- (1) Universiteti lëshon diplomë për përfundimin e studimeve universitare të ciklit të parë, të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë të studimeve (studime të doktoratës).
- (2) Diploma, nga paragrafi 1 i këtij neni, është në formë të fletës me dimensione 420x297 mm.
- (3) Diploma shtypet në masë 125 gr./mm², letër të mbrojtur, me vulë unike të njomë me shumë nuanca, me fibra fluoreshente, ose elemente të sigurisë në dy ngjyra, pa zbardhues. Në diplomë, e realizuar në teknikën blindruk vendoset stema e Republikës së Maqedonisë së Veriut, logo e universitetit, titulli "DIPLOMË", shiriti me ngjyrë të kuqe (nën vulën e thatë) dhe margjina, të cilat për ciklin e parë të studimeve janë me ngjyrë të kaltër, për ciklin e dytë të studimeve me ngjyrë të argjendtë, ndërsa për ciklin e tretë të studimeve me ngjyrë të artë.
- (4) Teksti i diplomës është në gjuhën shqipe, maqedonase dhe angleze.

Neni 3

- (1) Diploma për përfundimin e ciklit të parë të studimeve në bazë të nenit 2, të kësaj rregulloreje i përmban këto të dhëna: stemën dhe emrin e Republikës së Maqedonisë së Veriut; emrin e Universitetit; selinë; emrin e fakultetit; numrin dhe datën e vendimit për fillim me punë e lëshuar nga Ministria e Arsimit e Shkencës; titulli: „DIPLOMA për kryerjen e ciklit të parë të studimeve“; emrin dhe mbiemrin e studentit, datën e lindjes, numrin e identifikimit të studentit, përfundoi studimet derdiplomike (lloji, emri i programit të studimit dhe drejtimi), SETK kreditë, notën e përgjithshme mesatare dhe fitoi titullin shkencor/profesional; nivelin e kualifikimit; numrin dhe datën e diplomës nga libri kryesor i të diplomuarve në studimet e ciklit të parë; vendin dhe datën e lëshimit të diplomës; dekani; nënshkrimi, emri, mbiemri dhe titulli i

dekanit; rektori; nënshkrimi, emri, mbiemri dhe titulli i rektorit; dhe vulë e thatë e Universitetit.

- (2) Forma e diplomës për ciklin e parë të studimeve nga neni 1, paragrafi 1, është dhënë në shtojcën nr. 1, e cila është pjesë përbërëse kësaj rregulloreje.

Neni 4

- (1) Diploma për përfundimin e ciklit të dytë të studimeve në bazë të nenit 2, të kësaj rregulloreje i përmban këto të dhëna: stemën dhe emrin e Republikës së Maqedonisë së Veriut; emrin e universitetit; selinë; emrin e fakultetit/institutit; numrin dhe datën e vendimit për fillim me punë e lëshuar nga Ministria e Arsimit e Shkencës; titulli: „DIPLOMA për kryerjen e ciklit të dytë të studimeve“; emrin dhe mbiemrin e studentit, i/e lindur, përfundoi studimet pasdiplomike (lloji, emri i programit të studimit dhe drejtimi), SETK kreditë, notën e përgjithshme mesatare, emrin e temës dhe e fitoi titullin shkencor/profesional; nivelin e kualifikimit; numrin dhe datën e diplomës nga libri kryesor i të diplomuarve në studimet e ciklit të dytë; vendin dhe datën e lëshimit të diplomës; dekani/drejtori; nënshkrimi, emri, mbiemri dhe titulli i dekanit/drejtorit; rektori; nënshkrimi, emri, mbiemri dhe titulli i rektorit; dhe vulë e thatë e Universitetit.
- (2) Forma e diplomës për ciklin e dytë të studimeve nga neni 1, paragrafi 1, është dhënë në shtojcën nr. 2, e cila është pjesë përbërëse kësaj rregulloreje.

Neni 5

- (1) Diploma për përfundimin e ciklit të tretë –studime të doktoratës, në bazë të nenit 2, të kësaj rregulloreje i përmban këto të dhëna: stemën dhe emrin e Republikës së Maqedonisë së Veriut; emrin e universitetit; selinë; emrin e fakultetit/institutit; numrin dhe datën e vendimit për fillim me punë e lëshuar nga Ministria e Arsimit e Shkencës; titulli: „DIPLOMA për kryerjen e ciklit të tretë studimeve“; emrin, mbiemrin e studentit, i/e lindur, përfundoi studimet e ciklit të tretë (lloji i programit të studimit dhe drejtimi), SETK kreditë, notën e përgjithshme mesatare dhe mbrojtjen disertacionit me temë (emri i disertacionit) dhe fitoi titullin shkencore (titulli i fituar); nivelin e kualifikimit; numrin dhe datën e diplomës nga libri kryesor i të diplomuarve në studimet e ciklit të tretë; vendin dhe datën e lëshimit të diplomës; dekani/drejtori; nënshkrimi, emri, mbiemri dhe titulli i dekanit/drejtorit; rektori; nënshkrimi, emri, mbiemri dhe titulli i rektorit; dhe vulë e thatë e Universitetit.
- (2) Forma e diplomës për ciklin e tretë të studimeve nga neni 1, paragrafi 1, është dhënë në shtojcën nr. 3, e cila është pjesë përbërëse kësaj rregulloreje.

III. Forma dhe përmbajtja e Shtojcës së diplomës

Neni 6

- (1) Universiteti i Evropës Juglindore së bashku me diplomën lëshon edhe Shtojcën e diplomës.
- (2) Shtojca e diplomës nga paragrafi 1 i këtij neni, shtypet në letër të bardhë në masë 80 gr./mm² me ngjyrë të zezë bazike, në format 219x297 mm (A4), në mes është logoja e universitetit të Evropës Juglindore e realizuar me teknikën blindruk. Teksti përmban tetë pjesë (seksione), shkruhet në gjuhën shqipe, maqedonase dhe angleze, ndërsa fletët janë të lidhura me numër rendor.
- (3) Shtojca e diplomës nga paragrafi 1, i këtij neni, është dhënë në shtojcën nr. 4, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 7

Shtojca e diplomës nga neni 6, i kësaj rregulloreje, në faqen e parë përmban emrin dhe logon e universitetit, kodin QR, numrin e diplomës, titullin „Shtojca e diplomës“, sqarim të shkurtë për qëllimin, përdorimin dhe përmbajtjen e Shtojcës së diplomës.

Neni 8

- (1) Shtojca e diplomës në vazhdim ka tetë pjesë. Në pjesën e parë përmban të dhëna për mbajtësin e diplomës:
 - 1.1 Emri;
 - 1.2 Mbiemri;
 - 1.3 Datëlindja;
 - 1.4 Numri identifikues i studentit.
- (2) Në pjesën e dytë përmban të dhëna për kualifikimin e fituar:
 - 2.1 Emri i kualifikimit, emri i programit studimor, respektivisht lëmi kryesor i studimit;
 - 2.2 Fusha e studimit të kualifikimit;
 - 2.3 Emri dhe statusi i institucionit që jep kualifikimin;
 - 2.4 Emri dhe statusi i institucionit që lëshon diplomë;
 - 2.5 Gjuha në të cilën realizohen studimet.
- (3) Në pjesën e tretë përmban të dhëna për shkallën (ciklin) e kualifikimit:
 - 3.1 Lloji i kualifikimit (studime akademike/profesionale);
 - 3.2 Shkalla (cikli) i kualifikimit;
 - 3.3 Kohëzgjatja e programit studimor (e treguar me semestra, vite dhe SETK kredi);
 - 3.4. Kushtet për regjistrim në programin studimor.
- (4) Në pjesën e katërt përmban të dhëna për përmbajtjen dhe rezultatet e arritura:
 - 4.1 Regjimin e studimeve (të rregullta, me korrespondencë);
 - 4.2 Kërkesat dhe rezultatet e programit të studimit që t'u ndihmojë për të kuptuar se cilat njohuri, shkathtësi dhe kompetenca kanë fituar studentët që kanë përfunduar këto studime;
 - 4.3 Të dhëna për programin e studimit (drejtimin/moduli, notat dhe kreditë SETK);
 - 4.4 Sistemi i vlerësimit (skema e notave dhe kriteret për vlerësim);
 - 4.5 Nota e përgjithshme mesatare gjatë studimeve.
- (5) Në pjesën e pestë përmban të dhëna për shfrytëzimin e kualifikimit:

- 5.1 Qasja në studime të mëtejme;
 - 5.2 Statusi profesional (nëse është i ndryshueshëm).
- (6) Në pjesën e gjashtë përmban informata shtesë:
- 6.1 Informata shtesë për studentin;
 - 6.2 Informata shtesë për institucionin e arsimit të lartë (emri i institucionit, adresa, telefoni, e-maili, ueb faqja dhe të ngjashme).
- (7) Në pjesën e shtatë përmban informacione për verifikimin e diplomës shtesë:
- 7.1 Data dhe vendi i lëshimit;
 - 7.2 Emri, mbiemri dhe funksioni i nënshkruesit;
 - 7.3 Nënshkrimi
 - 7.4 Vula e Universitetit.
- (8) Në pjesën e tetë përmban informacione në lidhje me sistemin e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut:
- 8.1 Llojet e institucioneve të arsimit të lartë;
 - 8.2 Lloji i studimeve;
 - 8.3 Akreditimi i institucionit të arsimit të lartë;
 - 8.4 Struktura e arsimit të lartë universitar (programet studimore akademike);
 - 8.5 Struktura e studimeve të larta profesionale;
 - 8.6 Kushtet për regjistrimin në programet studimore;
 - 8.7 Sistemi i vlerësimit;
 - 8.8 Skema e sistemit arsimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Neni 9

Për përgatitjen e Shtojcës së diplomës, universiteti përdor udhëzimet për përgatitjen e Shtojcës së diplomës, të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

IV. Certifikata e diplomimit

Neni 10

- (1) Në fund të studimeve universitare lëshohet certifikatë diplomimi nga cikli i parë, i dytë apo tretë, me çka dëshmohet diplomimi nga cikli i parë, i dytë apo tretë.
- (2) Certifikata nga paragrafi 1 i këtij neni, shtypet në letër të bardhë në format 219x297 mm (A4), në të cilën logoja dhe emri i Universitetit janë realizuar në teknikën blindruk, ndërsa në mes të fletës në halogram logoja e Universitetit.
- (3) Teksti i certifikatës është në gjuhën shqipe, maqedonase dhe angleze.

Neni 11

- (1) Certifikata e diplomimit për ciklin e parë të studimeve përmban logon e Universitetit; emrin e Universitetit; numrin arkivor; bazën juridike për lëshimin e certifikatës; titullin „CERTIFIKATË për përfundimin e studimeve të ciklit të parë“; emrin dhe mbiemrin e studentit; datëlindjen e studentit; numrin e identifikimit të studentit; regjimi i studimeve; të dhëna për fakultetin; kohëzgjatja e studimeve (semestra); emrin e programit studimor dhe drejtimin; SETK kreditë, data e diplomimit; nota mesatare; titullin shkencor; nivelin e kualifikimit sipas Kornizës Nacionale të Kualifikimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut; nënshkrimin e Sekretarit të Përgjithshëm dhe vulën e Universitetit.
- (2) Certifikata e diplomimit nga paragrafi 1, i këtij neni, është dhënë në shtojcën nr. 5, e cila është pjesë përbërëse kësaj rregulloreje.

Neni 12

- (1) Certifikata e diplomimit për ciklin e dytë të studimeve përmban logon e Universitetit; emrin e Universitetit; numrin arkivor; bazën juridike për lëshimin e certifikatës; titullin „CERTIFIKATË për përfundimin e studimeve të ciklit të dytë“; emrin dhe mbiemrin e studentit; datëlindjen e studentit; numrin e identifikimit të studentit; të dhëna për fakultetin; kohëzgjatjen e studimeve (semestra); emrin e programit studimor dhe drejtimin; SETK kreditë; titullin e punimit të magjistraturës; titullin shkencor; datën e diplomimit; notën mesatare; nivelin e kualifikimit sipas Kornizës Nacionale të Kualifikimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut; nënshkrimi i Sekretarit të Përgjithshëm dhe vulën e Universitetit.
- (2) Certifikata e diplomimit nga paragrafi 1, i këtij neni, është dhënë në shtojcën numër 6, e cila është pjesë përbërëse kësaj rregulloreje.

Neni 13

- (1) Certifikata e diplomimit për ciklin e tretë të studimeve përmban logon e Universitetit; emrin e Universitetit; numrin arkivor; bazën juridike për lëshimin e certifikatës; titullin „CERTIFIKATË për përfundimin e studimeve të ciklit të dytë“; emrin dhe mbiemrin e studentit; datëlindjen e studentit; numrin e identifikimit të studentit; të dhëna për fakultetin; emrin e programit studimor dhe drejtimin; SETK kreditë; titullin e disertacionit të doktoratës; titullin shkencor; datën e diplomimit; notën mesatare; nivelin e kualifikimit sipas Kornizës Nacionale të Kualifikimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut; nënshkrimin e Sekretarit të Përgjithshëm dhe vulën e Universitetit.
- (2) Certifikata e diplomimit nga paragrafi 1, i këtij neni, është dhënë në shtojcën numër 7, e cila është pjesë përbërëse kësaj rregulloreje.

V. Transkripti i notave (*Transcript of Records*)

Neni 14

- (1) Universiteti, në fund të çdo semestri, gjegjësisht viti akademik, lëshon transkript të notave të studentit (*Transcript of records*), për provimet e dhëna nga cikli i parë, i dytë dhe i tretë, me të cilin dokumentohet progresi akademik i studentit dhe rezultati i arritur gjatë studimeve.
- (2) Transkripti i notave nga paragrafi 1, i këtij neni, shtypet në format 219x297 mm (A4), faqet janë të shënuara me numër rendor.
- (3) Transkripti zyrtar i notave (*Official Transcript of Records*), lëshohet me kërkesë të studentit dhe jepet në tre gjuhë, shqip, maqedonisht, ose anglisht, varësisht nga kërkesa e studentit.
- (4) Transkripti i notave është pjesë përbërëse e Certifikatës së diplomimit.

Neni 15

- (1) Transkripti i notave përmban të dhënat në vijim: emri i universitetit; emërtimi i dokumentit "Transkript e notave (*Transcript of Records*)"; kodin e sigurisë; datën e lëshimit të transkriptit; emrin dhe mbiemrin e studentit; numrin e identifikimit të studentit "ID"; emrin e programit studimor; numrin e kredive të programit studimor "SETK"; ciklin e studimeve; mënyrën e studimit.
- (2) Në vazhdim janë të dhënat akademike, si: kodi i lëndës; emërtimi i lëndës; semestri dhe viti kur është servisuar lënda përkatëse; kreditë e parapara sipas plan-programit; kreditë e fituara; nota; pikët e fituara për lëndën (GP), që paraqet shumën e numrit të kredive të lëndës dhe notës; në fund nota mesatare e përgjithshme (GPA), e cila fitohet nga numri i pikëve (GP), pjesëtuar me numrin e kredive të regjistruara.
- (3) Nëse studenti ka kredi të transferuara nga ndonjë institucion tjetër, shënohen në fund të transkriptit të notave dhe nuk merren në kalkulim të notës mesatare të përgjithshme.
- (4) Transkripti i notave vuloset nga shërbimet gjegjëse me vulë të universitetit.
- (5) Transkripti i notave (*Transcript of Records*), nga neni 14, paragrafi 1, është dhënë në shtojcën numër 8, e cila është pjesë përbërëse kësaj rregulloreje.

VI. Karta e studentit

Neni 16

- (1) Universiteti lëshon kartë studentit për çdo student gjatë regjistrimit në ciklin gjegjës të studimeve dhe mbetet pronë e Universitetit të Evropës Juglindore.
- (2) Karta e studentit është me format 84x54 mm, material plastike dhe përmban RFID Tag.
- (3) Karta e studentit përmban (në anën e parme), logon e universitetit; emrin e universitetit; titullin "KARTË STUDENTI"; emrin dhe mbiemrin e studentit; datëlindjen; datën e lëshimit (muaji dhe viti); numrin e identifikimit të studentit "ID#"; bar kod; fotografinë e studentit dhe ciklin e studimeve; (në anën e pasme), informacione për bartësin e kartës; vendin për nënshkrimin e studentit; logon e UEJL-së; kontaktet në universitet dhe pronësinë e kartës.

(4) Karta e studentit, nga paragrafi 1, i këtij neni, është dhënë në shtojcën nr.10, e cila është pjesë përbërëse kësaj rregulloreje.

Neni 17

Dokumentet nga kjo Rregullore lëshohen vetëm për ato programe studimore të përmendura në vendimin për akreditim dhe vendimin për të filluar me punën.

VII. Dispozitat përfundimtare

Neni 18

Kjo rregullore hyn në fuqi më 01.10.2019.